



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:164576

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521621

C. nr. 869/21

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, Dega Gllogoc - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtarin Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike kontestimore të paditësve, **H.E, H.Xh, I.G, I.K, I.I, L.R, L.B.1, L.B.2, S.N**, të gjithë punëtorë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gllogoc të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre H.H nga Gllogoci, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit-Drejtoria për Mirëqenie Sociale-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gllogoc, lidhur me kompensimin e pagës të trembëdhjetë, vlera e kontestit 5,338.00 €, jashtë shqyrtimit gjyqësor me datën 26.03.2024 e mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësve H.E, H.Xh, I.G, I.K, I.I, L.R, L.B.1, L.B.2, S.N të gjithë punëtorë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gllogoc dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gllogocit-Drejtoria për Mirëqenie Sociale-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gllogoc, që në emër të pagës së 13-të (trembëdhjetë) për vitin 2018 të i kompensoj paditësit si në vijim: H.E shumën prej 377.00 €, H.Xh shumën prej 377.00 €, I.G shumën prej 377.00 €, I.K shumën prej 314.00 €, I.I shumën prej 314.00 €, L.R shumën prej 565.00 €, L.B.1 shumën prej 377.00 €, S.N shumën prej 377.00 €, **ndërsa paditësit L.B.2** në emër të pagës së 13-të (trembëdhjetë) për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 të i bëhet kompensimi nga i padituri nga 565.00 € në vit e në shumën e përgjithshme prej 2,260.00 €, për të gjitha këto për secilin paditës me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datën 26.03.2024 e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 372.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditë nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.
- II. REFUZHET** pjesa e kërkesëpadisë së paditësve H.E, H.Xh, I.G, I.K, I.I, L.R, L.B.1, L.B.2, S.N për kompensimin të pagës së trembëdhjetë për vitet 2019, 2020 dhe 2021 **për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.**
- III. REFUZHET** si e pabazuar kërkesa e paditësve që të detyrohet i padituri të ua paguaj edhe shpenzimet procedurale mbi shumën e aprovuar nga pika I e këtij dispozitivi.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve:

Paditësit, në padi dhe në precizimin e padisë përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre kanë theksuar se: *paditësit janë punëtorë të rregullt e të paditurës dhe në pajtim me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, paditësve ju takon kompensimi i pagës së trembëdhjetë për çdo vit kalendarik, dhe sipas këtij neni punëmarrësi ka të drejtën e kompensimit të pagës së 13 për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë, po ashtu zbatimi i kontratës kolektive sektoriale parashihet në Nenin 4 të saj se e paditura është e obliguar që të zbatoj Kontratën Kolektive Sektoriale, të njëjtit*

kanë theksuar se heqin dorë nga kërkesëpapia për kompensimin e pagës së trembëdhjetë për vitet 2019, 2020, 2021, pasi që për këto vite janë kompensuar nga e paditura.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se: *Komuna nuk ka obligime financiare për Koston e Kontratës Kolektivë Sektoriale sepse e njëjta nuk ka qene nënshkruese e kësaj kontrate, dhe në anën tjetër niveli qendror konkretisht Ministria e Financave nuk kanë buxhetuar kostot e kësaj kontrate. Tutje ka theksuar se në bazë të Nenit 4 par. 3 parashihet se “benificionet që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e ligjit të punës i gëzojnë vetëm anëtarët e FSSHK-së e në këtë rast të njëjtit nuk e kanë dëshmuar se kanë qenë anëtarë të FSSHK-së.*

Gjendja faktike, provat e administruara dhe ligji material i zbatuar:

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të Nenit 8 lidhur me Nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpapia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim kryesor të çështjes e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartazi se padia e paditësve është e bazuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit H.E, H.Xh, I.G, I.K, I.I, L.R, L.B.1, L.B.2, S.N, janë në marrëdhënie pune tek e paditura si Infermiere në QKMF “Hafir Shala në Glllogoc. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve iu takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës për pagën e trembëdhjetë.

Në këtë drejtim, gjykata përmes Vërtetimit me nr... e dt. 07.06.2021 nga kontrata e punës me numër 06-... e dt. 01.01.2012 e lidhur ndërmjet paditësës H.E dhe të paditurës rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... të dt. 08.06.2021 nga kontrata e punës me numër... të dt. 31.12.2020 e lidhur ndërmjet paditësit H.Xh dhe të paditurës rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... të dt. 08.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër 06-... e dt. 01.01.2012 e lidhur ndërmjet paditësës I.G dhe të paditurës rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... të dt. 07.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër... të dt. 31.12.2020 e lidhur ndërmjet paditësit I.K dhe të paditurës rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... të dt. 17.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër... e dt. 31.12.2020 e lidhur ndërmjet paditësit I.I dhe të paditurës rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... të dt. 10.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër 06-... e dt.28.02.2013 e lidhur ndërmjet paditësës L.R dhe të paditurës rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... te dt. 14.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër 6-Nr... e dt .25.05.2017 lidhur ndërmjet paditësit L.B.1 dhe të paditurës rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... të dt. 07.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër 06-... e dt.0 1.01.2012 e lidhur ndërmjet paditësës L.B.2 dhe të paditurës rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura, përmes Vërtetimit me nr... e dt. 08.06.2021 dhe nga kontrata e punës me numër 06-... e dt. 01.01.2012 e lidhur ndërmjet paditësës S.N dhe të paditurës rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura,

Po ashtu, në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës me nr.01 Nr... i dt. 30.11.2022 dhe të precizimit të padisë të dt. 27.02.2024 nga përfaqësuesi i paditësve për pagesën e pagave të trembëdhjetë, gjykata vërtetoi faktin se palëve paditëse, përveç paditësit L.B.2, u është bërë kompensimi i pagës së trembëdhjetë për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nga i padituri në procedurën administrative, andaj gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Provat e lartëcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare në kuptim të Nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj, meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar gjykata ua fali besimin e plotë.

Gjykata ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e paditësve dhe kundërshtimet e të paditurës sa i përket pagave të trembëdhjeta dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës ka konstatuar se paditësve në rastin konkret iu takojnë pagat e trembëdhjeta ashtu siç është vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase sipas Nenit 17 par. 2 e Kontratës Kolektive Sektoriale Nr. 05-3815, e cila ka hyrë në fuqi më datë 16.06.2018 është paraparë se Punëmarrësi mund të kompensohet me pagesën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.

Në bazë të gjendjes së tillë të çështjes, provave të administruara dhe dispozitave të lartcekura, pamëdyshje dhe në mënyrë të sigurtë rezulton se kërkesa e paditësve duhet Aprovuar, me arsyetimin se, duke qenë se dispozita e Nenit 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale në një mënyrë e detyron punëdhënësin (këtu të paditurën) për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për shkak se e njëjta thotë se punëmarrësi mund të paguhet me pagën e 13-të për çdo vit kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, e meqë në rastin konkret e paditura përveç pretendimet të dhënë në përgjigje në padi nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte se nuk kanë mjete financiare për të realizuar obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, nuk e ka arsyetuar pamundësinë e mjeteve buxhetore për pagesën e pagës së trembëdhjetë për paditësit, si dhe duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr. 212/2023 të dt. 09.10.2023 ka theksuar se nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e pagës së 13-të duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për të u deklaruar me prova konkrete të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. Në rastin konkret punëdhënësi tani e paditura nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi konkrete me të cilën do të bënte ë besueshme pretendimin e tyre për mungesën e mundësisë buxhetore, andaj gjykata konform dispozitës ligjore të lartëcekur vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në Nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale Nr. 05-3815, e cila ka hyrë në fuqi më datë 16.06.2018. Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim që paditësve të ua paguaj kompensimin e pagës se 13-të konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale dhe sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme nr. 212/2023 të dt. 09.10.2023.

E paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh ndaj paditësve për pagesën e pagave të trembëdhjeta, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor në të cilin paditësja e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në Nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) që parashihet se *“kreditori në*

marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj, gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditëses me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ua kompensoj detyrimin si në shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kontratat e punës është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht dispozitat nga Neni 11 i po të njëjtit ligj ku parashihet përmbajtja e kontratës së punës. Ndërsa pika 1.13. që përcakton të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Është rregull e përgjithshme edhe parimi i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijohet raporti juridik gjegjësisht marrëdhënia juridike, si dhe po ashtu me këtë vullnet mund të ndryshojnë marrëdhëniet juridike, pasi që **kontrata është ligj për palët (Pacta Sund Servanda)**, andaj duke u mbështetur në këtë parim palët kontraktuese marrin për obligim që ti përmbushin obligimet e tyre kontraktuese ashtu siç figurojnë në kontratë, apo ta ndryshojnë atë me ndonjë kontratë të mëvonshme.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, sepse e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit për pjesën e aprovuar të kërkesës e që sipas **Nenit 7 par. 1 të LPK-së** që përcakton se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”,* dhe në **Nenin 319 par. 1 të LPK-së** që përcakton se *“Secila nga palët ndërgjygjëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.* Gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Gjykata duke u bazuar në Nenin 149 par. 1 të LPK që përcakton se *“Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi”* vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilin është pjesa e kërkesëpadisë së paditësve lidhur me kompenzimin e pagës së 13-të për vitet 2019, 2020 dhe 2021, pasi që e paditura në përgjigje në padi ia ka bashkangjitur Vendimin e Inspektoratit të Punës me nr. 01 Nr... të dt. 30.11.2022 me të cilin gjykata vërtetoi faktin se palëve paditëse i padituri ua ka bërë pagesën e pagës së 13-të për vitet 2019, 2020 dhe 2021 në procedurë administrative, dhe mbi bazën e kësaj ka vendosur që të refuzojë pjesën e kërkesëpadisë së paditësve për vitet e lartëcekura për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet Nenin 382 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili ka përcaktuar *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”,* dhe si moment të fillimit të kamatës gjykata ka marr datën e marrjes së aktgjykimit gjegjësisht prej datës 26.03.2024.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është marrë konform Nenin 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me Nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditësve të ua paguajë shumën e përgjithshme prej 372.00 Euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 Euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 60 Euro sepse në bazë të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së me Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore në Nenin 12 është

paraparë se “për vlerë të kontestit prej 5001 Euro gjer 10000 Euro tarifa gjyqësore është 60 Euro” e jo shumën prej 101 Euro për taksë gjyqësore.

Kurse vendimin nga pika III e dispozitivit me të cilën është refuzuar kërkesa e paditësve për shpenzime procedurale mbi shumën e aprovuar nga pika I e këtij dispozitivi, gjykata e ka mbështetur në Nenin 453 par. 1 lidhur me Nenin 463 par. 1 të LPK-së, për shkak se për padi për dy e më paditës e sipas Nr. tarifor 10 të Tarifës së OAK parashihet se “*Kur avokati përfaqëson dy apo më shumë palë ose nëse si palë kundërshtare ka më shumë persona, për përpilimin e të gjitha parashtrësave dhe për përfaqësimin në seanca gjyqësore, avokatit i takon shpërblimi i rritur për 50 % për palën e dytë dhe secilën të mëtutjeshme por jo më shumë se deri në trefishin e shumës së paraparë me këtë Rregullore*”, e që trefishi në këtë rast është 312 euro i shumës bazë prej 104 Euro për një paditës.

Ndërsa për shpenzimet e kërkuara nga paditësit edhe për parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë në shumën prej 624 Euro gjykata e ka refuzuar sepse në nr. tarifor 6 të Tarifës së OAK-së njihen shpenzimet për parashtrësën me të cilat iniciohet procedura e nuk njihen shpenzimet edhe për parashtrësat për precizim të kërkesëpadisë, dhe për shpenzimet për përfaqësim në një seancë gjyqësore në shumën prej 811,20 Euro gjykata i ka refuzuar sepse më këtë çështje kontestimore nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore sepse është marr aktgjykim jashtë seancës gjyqësore.

Duke u bazuar në të lartëcekurat gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me Nenin 398 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C. nr. 869/2021, datë 26.03.2024**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër pikës I dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate, ndërsa kundër pikës II të dispozitivit vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit, gjegjësisht e heqjes dorë nga kërkesëpadia, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit (Neni 181 par. 2 i LPK-së).